



*Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 pika d) si dhe nenit 40.paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 17, 38, 60 dhe 61 Ligjit për Financa Publike dhe Pergjegjesit nr 05/L-1007 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-048 nenit 7 dhe 8 të Rregullorës Komunale Për Ndarje të Subvencione dhe Transfereve Nr 06-4043/2015 , nenit 16 paragrafi 8 pika 8.2 i Ligjit Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, nenit 92 të Statutit të Komunës, me kërkesën e drejtoris për Financa Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë: 24.11.2023.mori këtë:*

## V E N D I M

### *Për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për participim*

1. Aprovohet propozim-vendimi i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri - për "Furnizim me mekanizëm bujqësor - Mbjellëse për misër" në shumë prej: 3,595.50 euro- Kategoria Ekonomike Subvencione dhe Transfere.
2. Projekti i ri do të krijohet me mjetet nga participimi i qytetarëve bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit në mes të komunës dhe qytetareve, ku në këtë rast Komuna e Klinës financon me 70% të vlerës së projektit, ndërsa qytetarët me 30%, emri i projektit "Furnizim me mekanizëm bujqësor - Mbjellëse për misër".
3. Komuna financon me mjete financiare në shumë prej 8,389.50 euro nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere, Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural kodi programit (47018) kurse qytetarët kanë participuar me 3,595.50 euro, vlera e tërësishme e projektit është 11,985.00 euro.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.
6. Më këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-40617 2023  
Klinë, më 25.11 /2023



Kryesuesi  
Fadil Gashi